



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 15.7. 2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 115/2016 "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 15.7.2019, mori në shqyrtim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e projektligjit deputeten znj. Klotilda Bushka.

Në mbledhjen e Komisionit për të diskutuar mbi projektligjin, si dhe për të dhënë opinionin e tyre ishin të pranishëm, z.Ardian Dvorani, Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, z. Maksim Qoku, nënkryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe z. Ilir Toska, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj.Agnes Bernhard, drejtuese e Misionit EURALIUS V, dhe Znj.Fjoralba Caka, zv/Ministre e Drejtësisë.

I. PROPOZIMI I PROJEKTLIGJIT

Kuvendi i Shqipërisë më datë 03.11.2016 ka miratuar ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" ("ligji 115/2016") i cili ka përcaktuar parimet dhe rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Ligji 115/2016 është bërë objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese me kërkesë të disa shoqatave të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe një grupi jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Në përfundim të shqyrtimit në seancë plenare, Gjykata, nëpërmjet vendimeve 41/2017 dhe 78/2017, shfuqizoi disa prej dispozitave të ligjit. Dispozitat e shfuqizuara të ligjit për organet e qeverisjes lidhen me shkeljet disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillave, ushtrimin e funksioneve nga Komisionet dhe mbledhjet plenare të Këshillave, marrëdhëniet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Ministrin e Drejtësisë, si dhe procedurën e përjashtimit të një anëtari të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative.

Këshilli për Legjislacionin në Kuvend, në përmbushje të detyrimit kushtetues për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, pasi ka marrë në shqyrtim vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të analizës dhe diskutimeve, si dhe bazuar në opinionin e paraqitur nga ekspertët, vendosi të ndërmarrë nismën ligjore për të bërë disa amendamente në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me qëllim reflektimin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese.

Projektligji është depozituar në Kuvend si nismë deputetësh, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës sipas të cilës miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit “a)ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta”. Për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar prej 3/5 (tre të pestat) e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji propozon rregullimin dhe plotësimin e disa dispozitave të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të disa neneve të këtij ligji, me vendimet nr.41/2017 dhe nr.78/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshimet që propozohen janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët gjatë veprimtarisë së tyre po hasin vështirësi për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore për mbledhjet plenare të këshillave, që ka sjellë probleme në funksionimin dhe vendimmarrjen e tyre.

Gjithashtu, shfuqizimi i disa neneve për shkeljet disiplinore ka cenuar veprimtarinë e Këshillave në drejtim të hetimit dhe të procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Konkretisht:

-Projektligji synon të plotësojë rregullimet ligjore lidhur me shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Neni 5 i shfuqizuar i ligjit 115/2016 synonte të rregullonte

përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky nen nuk përmbante ndonjë rregullim thelbësor, mbi shkeljet disiplinore por i referohej rregullimit më të detajuar të së njëjtës lëndë (përgjegjësisë disiplinore) në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Neni i shfuqizuar përcaktonte se i gjithë rregullimi për përgjegjësinë disiplinore të magistratëve do të zbatohet *mutatis mutandis* ndaj anëtarëve të Këshillit.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.41/2017 konstatoi se:” 41.Në zbatim të frymës së parimit të sigurisë juridike, Gjykata çmon se për shkak të specifikës dhe statusit të anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së, përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore në mënyrë shteruese në nenet 5 dhe 103 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” është detyrim ligjor që rrjedh nga Kushtetuta. Gjykata çmon se mosparashikimi ose referimi të një ligj tjetër cenon statusin e këtyre organeve kushtetuese, që duhet të kenë siguri juridike gjatë qëndrimit në detyrë.”

Në reflektim të vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese, është propozuar një reformulim i nenit 5, për të ofruar një rregullim specifik për rastet që do të konsiderohen shkelje disiplinore për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

-Në vazhdim të përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, propozohet në projektligj shtesa e tre neneve të reja, 5/1, 5/2 dhe 5/3, në të cilat është bërë një ndarje e shkeljeve disiplinore, sipas natyrës së tyre në:

- shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;
- shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;
- shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale.

- Gjykata Kushtetuese, me vendimin 41/2017, shfuqizoi nenin 61 të ligjit 115/2016, me arsyetimin se: “21.Gjykata konstaton se kompetencat, si transferimi i gjyqtarëve/prokurorëve, vendosja e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të të gjitha niveleve, propozimi Presidentit të Republikës i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, propozimi Kuvendit i kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, propozimi dhe administrimi i buxhetit apo dhe miratimi i rregullave të etikës dhe mbikëqyrja e respektimit të saj, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta, nuk janë parashikuar si kompetenca që ushtrohen respektivisht nga mbledhjet plenare të KLGJ-së dhe KLP-së. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se të gjitha kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta duhet të implementohen si të tilla në ligj dhe nuk mund t’u delegohen komisioneve.”

Neni 61 i shfuqizuar listonte të gjitha kompetencat e KLGJ të cilat sipas ligjvënësit duhet të ushtrohen nga mbledhja plenare e Këshillit. Lista e nenit 61 përfshinte vetëm disa nga kompetencat që Kushtetuta i kishte veshur KLGJ-së, ndërkohë që gjithë kompetencat e tjera (të parashikuara nga Kushtetuta) do të ushtroheshin nga komisionet e përhershme.

Në respektim të vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, neni 61 i reformuluar parashikon se Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare ushtron gjithë të gjitha kompetencat e tij kushtetuese.

-Pas shfuqizimit që Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.78/2017, i ka bërë pikës 2 të nenit 76 të ligjit, me reformulimin që propozohet për këtë nen, kompetenca për përjashtimin e një

anëtari të Këshillit i takon vendimmarrjes së vetë Këshillit, dhe në rastin kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit, zëvendëskryetari ka vetëm tagrin e drejtimit të mbledhjes.

-Projektligji parashikon dhe rregullimin e dispozitës lidhur me shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Neni 103 i shfuqizuar, kishte për synim të rregullonte përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke përcaktuar se ndaj anëtarëve të Këshillit do të zbatoheshin për aq sa ishte e mundur, dispozitat e ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjykata Kushtetuese konstatoi se referenca në ligjin për statusin përbënte një shkelje ndaj parimit kushtetues për sigurinë juridike. Për shkak të veçantisë së statusit të anëtarëve të KLGJ dhe KLP (*shiko paragrafin 41 të vendimit 41/2017 të Gjykatës Kushtetuese*) ligji duhet të parashikojë shkelje disiplinore specifike për këta funksionarë. Bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe të detyrimit që sjell ky vendim për qartësinë e dispozitave ligjore, propozohet ndryshimi i nenit 103 të ligjit, për të mundësuar një rregullim specifik dhe të përshtatshëm për çështjen e përgjegjësisë dhe shkeljeve disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

-Në vazhdim të përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, propozohet shtesa e tre neneve të reja, 103/1, 103/2 dhe 103/3, në të cilat është bërë një ndarje e shkeljeve disiplinore, sipas natyrës së tyre në:

- shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;*
- shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;*
- shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale.*

-Në vazhdim të rregullimeve që janë bërë në nenin 61 të ligjit, propozohet që të bëhen rregullime edhe në nenin 159 të ligjit. Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi nenin 159 të ligjit 115/2016 me arsyetimin se të gjitha kompetencat që i janë dhënë KLP-së nga Kushtetuta duhet të ushtrohen nga mbledhja plenare e Këshillit dhe jo nga komisionet e përhershme (*shih paragrafët 21 dhe 22 të Vendimit 41/2017 të Gjykatës Kushtetuese*), të cilët mund të ketë vetëm një rol ndihmës.

Për këtë arsye, në respektim të vlerësimit të GJK, hartimi i ndryshimit të propozuar parashikon se Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare ushtron gjithë të gjitha kompetencat e tij kushtetuese.

-Në projektligj propozohet të bëhet dhe një rregullim në nenin 175 të ligjit, për analogji me rregullimin që është propozuar më sipër për Këshillin e Lartë Gjyqësor, pas shfuqizimit që Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.78/2017, i ka bërë pikës 2 të nenit 76 të ligjit.

Me riformulimin e propozuar, kompetenca për përjashtimin e një anëtari të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i takon vendimmarrjes së vetë Këshillit, dhe në rastin kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit, zëvendëskryetari ka vetëm tagrin e drejtimit të mbledhjes.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Pas depozitimit dhe përfshirjes së dy nismave ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në Kalendarin e Punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, këto nisma i janë përcjellë për mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Shkollës së Magjistraturës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Bazuar në nenin 93 dhe 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë japin mendim për projektligjet ose për çështje të tjera që mund të ndikojnë mbi sistemin gjyqësor/prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi.

Paralelisht me kërkesën për dhënien e mendimeve, është ngritur edhe një grup pune me përfaqësues të institucioneve të sipërcituara, me asistencën e misionit EURALIUS, me qëllim:

- a. Reflektimin në përmbajtjen e dispozitave të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese të komenteve dhe sugjerimeve të Këshillave në funksion të qartësisë sa më të plotë të normave dhe garantimit të parimit të sigurisë juridike.
- b. Reflektimin e shqetësimeve më imediate që këto organe kanë hasur gjatë zbatimit të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë.

Projektligji, në formën integrale, është produkt i dakordësisë së arritur në grupin e punës.

IV. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, nga relatorja u theksua rëndësia e miratimit të kësaj nisme ligjore, si domosdoshmëri për plotësimin e vakuimit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i disa dispozitave nëpërmjet vendimeve 41/2017 dhe 78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, por edhe për sigurimin e bazës rregullatore për ushtrimin e plotë të kompetencave nga organet e reja të sistemit të drejtësisë, bazuar në arsyetimin e dhënë në vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese.

Relatorja vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të maxhorancës dhe opozitës në këtë proces, në veçanti gjatë veprimtarisë së Këshillit për Legjislacionin në muajt Maj-Qershor, bashkëpunim i cili krijoi premisat e nevojshme për finalizimin e ndërmarrjes së nismave ligjore për reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë vlerësuan këtë nismë ligjore si një nevojë për garantimin e funksionimit normal dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Përfaqësuesit e Këshillave u shprehën në mbështetje të këtyre nismave ligjore, duke theksuar domosdoshmërinë për adresimin në dispozitat e ligjit të disa çështjeve të gjykuara imediate për garantuar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij. Njëkohësisht ato u shprehën

edhe për nevojën e ndërhyrjeve të tjera në ligj të cilat mund të propozohen në një moment të dytë. Lidhur me këtë konstatim të përfaqësuesve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Komisioni, duke vlerësuar rëndësinë e zbatimit të paketës së reformës në drejtësi u shpreh i gatshëm që të marrë me përparësi në shqyrtim, në vazhdim, çdo propozim të ardhur dhe që mund të vijë lidhur me këto ligje, dhe që nuk është adresuar në këtë projektligj.

V. PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA NË KOMISION

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjeve, duke marrë parasysh dhe rekomandimet dhe propozimet e paraqitura nga relatorja dhe grupi i punës, miratoi disa shtesa dhe ndryshime, të cilat do të reflektohen në tekstin integral të projektligjit, dhe që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë :

- Bazuar në argumentimin e shprehur në vendimin 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese (paragrafi 75) në të cilin kjo Gjykatë arsyeton se: *“Gjykata konstaton se paqartësia e normave reflektohet në tërësinë e ligjit, për rrjedhojë i sugjerohet ligjvënësit që në procesin e rishikimit të ligjit, objekt kundërshtimi, të marrë në konsideratë nevojën për përmirësimin në tërësi të terminologjisë së përdorur në hartimin e normave ligjore, për të garantuar pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën...”* janë propozuar rregullime të natyrës teknike të cilat:

- i. kanë ardhur si propozime të Këshillit të Lartë Gjyqësor siç është rasti i përcaktimit të afateve të ankimit në gjykatën administrative të apelit (ndërhyrjet në nenet 100 dhe 192 të ligjit);
- ii. ose janë konstatuar nga grupi i punës si të domosdoshme për qartësinë e dispozitave të veçanta (ndërhyrjet në nenet 6, 104, 225 të ligjit).

Me qëllim garantimin e funksionimit normal të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga ky institucion është propozuar një shtesë në nenin 220 të ligjit, me qëllim parashikimin në aktet e brendshme të KED të procedurave për caktimin e anëtarëve zëvendësues, për të realizuar kuorumin e mbledhjeve.

Njëkohësisht, me qëllim garantimin e ngritjes dhe të mirëfunksionimit të KED-së janë parashikuar disa ndërhyrje në nenin 221 të ligjit. Këto ndryshime që propozohen nga vetë KED, synojnë përcaktimin e qartë në këtë ligj, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e tjera të reformës në drejtësi, të kriterëve të magjistratëve që përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin

në fuqi;

- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi dy projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, e miratoi sipas tekstit integral bashkëlidhur, i cili i përcillet për votim seancës plenare.

RELATORE

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

KRYETAR

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ
NR. ____/2019

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë kur:

a) kryen veprime ose mosveprime të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose jo etike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor;

b) gjatë ushtrimit të funksionit, nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor konsiderohet shkelje disiplinore ose një çështje e veprimtarisë profesionale, në çdo rast duhet të merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshësia e veprimit ose mosveprimit;

c) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi ose mosveprimi; si dhe

ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.”

Neni 2

Pas nenit 5 shtohen nenet 5/1, 5/2, 5/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, janë në veçanti, por nuk kufizohen vetëm në veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

a) Mosparaqitja e kërkesës për heqje dore nga pjesëmarrja në mbledhjen plenare ose në mbledhjet e komisioneve, kur është e detyrueshme sipas ligjit, nëse anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka dijeni ose duhet të kishte dijeni për rrethana të tilla;

b) Paraqitja e kërkesës për heqje dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse ky veprim:

i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

(ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për subjektin e procedurës administrative ose synon shmangien e përgjegjësisë ligjore si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor apo caktimin e çështjes një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

(iii) nuk paraqitet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) Ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ç) Mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve;

d) Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda, apo zvarritje të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) Veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që sjell përfitime të padrejta ose dëmtim të subjektit të procedurës administrative;

e) Angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë anëtarit, ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ë) Mungesë e pajustificuar në detyrë sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

f) Shkelje e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;

g) Mosnjoftimi i Kryetarit të Këshillit si dhe autoriteteve kompetente sipas ligjit mbi ndërhyrjet ose forma të tjera të ndikimit nga magjistratët, avokatët, funksionarë politikë, zyrtarët publikë ose subjekte të tjera;

gj) Shkelje e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

h) Pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo ndonjë organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve sipas legjislacionit në fuqi;

i) Mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

- j) mosrespektimi i detyrimeve ligjore, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- k) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 5/2

Shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por nuk kufizohen vetëm në, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:

- a) përdorimi i pozicionit të anëtarit të Këshillit për krijimin e përfitimeve të pajustificuara për veten ose për të tretët;
- b) ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit, me pagesë, duke mos respektuar rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi ;
- c) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar dhe të parahabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me anëtarin e Këshillit, ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;
- ç) përfitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimit preferencial të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit të ushtruar ose për shkak të përdorimit të pozitës si anëtar i Këshillit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;
- d) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e anëtarit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 5/3

Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale

1. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë veprime, mosveprime ose sjellje, për të cilat anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është dënuar me vendim të formës së prerë dhe që sipas natyrës së tyre diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.
2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprimet, mosveprimet ose sjelljet, sipas pikës 1 të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia.
3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” zbatohen për aq sa është e nevojshme.”

Neni 3

Në nenin 6, në pikën 4, pas fjalëve “vendos në bazë” shtohen fjalët “të këtij ligji,”.

Neni 4

Neni 61, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61

Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
 - c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) drejton dhe kujdeset për veprimtarinë në administratën e gjykatave;
 - dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe atë të gjykatave;
 - e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
 - ë) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera , me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike;
 - f) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;
 - g) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;
 - gj) shqyrton sipas rastit vendimet e komisioneve;
 - h) miraton udhëzime jo detyruese;
 - i) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;
 - j) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre.
3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit, për çështje të mëposhtme të rendit të ditës:
 - a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;
 - b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të këtij ligji.
4. Komisionet kryejnë veprimtari të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme.

Neni 5

Paragrafi 2, i nenit 76, ndryshohet si më poshtë:

“2. Vendimi për përjashtimin e një anëtari nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose komision, merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.”

Neni 6

Në nenin 100, në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj.”

Neni 7

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 103

Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit, ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose dëmtojnë besimin e publikut te prokuroria;

b) gjatë ushtrimit të funksionit, nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë konsiderohet shkelje disiplinore ose një çështje e veprimtarisë profesionale, në çdo rast duhet të merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e veprimit ose mosveprimit;

c) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi ose mosveprimi; si dhe

ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e prokurorisë.”

Neni 8

Pas nenit 103 shtohen nenet 103/1, 103/2, 103/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 103/1

Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, janë në veçanti, por nuk kufizohen vetëm në, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

a) Mosparaqitja e kërkesës për heqje dore nga pjesëmarrja në mbledhjen plenare ose në mbledhjet e komisioneve, kur është e detyrueshme sipas ligjit, nëse anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka dijeni ose duhet të kishte dijeni për rrethana të tilla;

b) Paraqitja e kërkesës për heqje dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nëse ky veprim:

i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

(ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për subjektin e procedurës administrative ose synon shmangien e përgjegjësisë ligjore si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo caktimin e çështjes një anëtar tjetër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

(iii) nuk paraqitet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) Ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një anëtar tjetër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

ç) Mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve;

d) Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda, apo zvarritje të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) Veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që sjell përfitime të padrejta ose dëmtrim të subjektit të procedurës administrative;

e) Angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë anëtarit, ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,;

ë) Mungesë e pajustificuar në detyrë sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

f) Shkelje e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

g) Mosnjoftimi i Kryetarit të Këshillit si dhe autoriteteve kompetente sipas ligjit mbi ndërhyrjet ose forma të tjera të ndikimit nga magjistratët, avokatët, funksionarë politikë, zyrtarët publikë ose subjekte të tjera;

gj) Shkelje e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjisllacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,;

h) Pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo ndonjë organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve sipas legjisllacionit në fuqi;

i) Mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

j) mosrespektimi i detyrimeve ligjore, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

k) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi.

Neni 103/2

Shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por nuk kufizohen vetëm në veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si vijon:

- a) përdorimi i pozicionit të anëtarit të Këshillit për krijimin e përfitimeve të pajustificuara për veten ose për të tretët;
- b) ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit, me pagesë, duke mos respektuar rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- c) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me anëtarin e Këshillit, ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;
- ç) përfitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimit preferencial të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit të ushtruar ose për shkak të përdorimit të pozitës si anëtar i Këshillit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;
- d) raste të tjera të sjelljes që diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit dhe dëmton besimin e publikut të prokuroria, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 103/3

Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale

1. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë veprime, mosveprime ose sjellje, për të cilat anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është dënuar me vendim të formës së prerë dhe që sipas natyrës së tyre diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut të prokuroria, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.
2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprimet, mosveprimet ose sjelljet, sipas pikës 1 të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia.
3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” zbatohen për aq sa është e nevojshme.”

Neni 9

Në nenin 104, në pikën 4, pas fjalëve “vendos në bazë” shtohen fjalët “të këtij ligji.”.

Neni 10

Në nenin 157 pika 3, shkronja “dh”, fjalët “sistemin gjyqësor” zëvendësohen me fjalën “prokurori”.

Neni 11

Neni 159, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 159
Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
 - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
 - dh) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e prokurorisë;
 - e) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë prokurorët;
 - ë) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;
 - f) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;
 - g) shqyrton sipas rasti vendimet e komisioneve;
 - gj) miraton udhëzime jo detyruese;
 - h) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;
 - i) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre.
3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose Komisionit, për çështje të mëposhtme të rendit të ditës:
 - a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;
 - b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 160, të këtij ligji.
4. Komisionet kryejnë veprimtari të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme.”

Neni 12

Paragrafi 2, i nenit 175, ndryshohet si më poshtë:

“2. Vendimi për përjashtimin e një anëtari nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose komision, merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në nenin 171 të këtij ligji. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.

Neni 13

Në nenin 192, në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj.”

Neni 14

Në nenin 220, në fund të pikës 3 shtohen fjalët “sipas rregullave të përcaktuara në aktet e Këshillit.”.

Neni 15

Në nenin 221, pika 1 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) në kohën e hedhjes së shortit magjistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 10 vjet”.

2. Shkronjat “ç” dhe “d” shfuqizohen.

3. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme”.

Neni 16

Në nenin 225, pika 1, togfjalëshi “nenet 133 dhe 134,” ndryshohet dhe bëhet “nenet 222, 223 dhe 224.”.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI